



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD.nr.12/2021

G.JYKATA THEMELORE NË PRIZREN, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinor, duke vepruar sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 28.10.2021 e parashtruar nga **H.K.**, nga, ndaj gjyqtarit **A.H.**, me datë **15.11.2021** mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa e **H.K.**, nga, e parashtruar me datën 28.10.2021, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit **A.H.**,

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës **H.K.**, me datën 28.10.2021 ka parashtruar ankesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit **A.H.**, në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës ka përshkruar rrjedhën e gjykimit dhe vendimet që janë marrë në procedurën kontestimore C.nr., sipas padisë së paditësit **M.K.**, nga, dhe të paditurit **H.K.**, tani si parashtrues i kësaj anese. Nga përmbajtja e ankesës parashtruesi ka përshkruar fakte dhe rrethana që lidhen me objektin e kontestit dhe ka shprehur pakënaqësi lidhur me aktvendimin procedural të çështjes C.nr., të datës 27.09.2021 me të cilin e ka detyruar parashtruesin në cilësinë e të paditurit që të paraqes përgjigje në padi brenda afatit 15 ditor. Nga analizimi i kërkesës në pikëpamje të përgjithshme shihet se parashtruesi ka theksuar fakte dhe rrethana që lidhen me objektin e çështjes, procedurën dhe vendimet e marra deri me tani.

Gjyqtari **A.H.**, me parashtrëse të veçantë ka përshkruar rrjedhën e lëndës penale dhe në lidhje me pretendimet e ankuesit ka theksuar se nuk qëndrojnë të njëjtat pretendime sepse nga përmbajtja e kërkesës së tij nga vendosja në çështjen juridike kontestimore C.nr., rrjedh sikurse unë ta kisha paditur atë pranë kësaj Gjykate.

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraprak, shikimit në shkresat e lëndës penale C.nr., analizimit të ankesës së parashtruesit, deklaratës së gjyqtarit të çështjes, konstaton se kërkesa është e pa bazuar.

U.D. Kryetari i Gjykatës fillimisht konstaton parashtruesi i kërkesës në këtë lëndë është në cilësi të paditurit sipas padisë së paditësit **M.K.**, nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë. Gjyqtari i çështjes siç shihet nga shkresat e lëndës, ka marrë veprime duke i dërguar padinë të paditurit për përgjigje ashtu siç parashikohet me dispozitat ligjore të LPK-së ndërsa pas pranimit të përgjigjes në padi nga i padituri çështja është e gatshme për shqyrtim përgatitor apo varësisht si e vlerëson gjyqtari i çështjes.

U.D. Kryetari i Gjykatës lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit gjeti se të njëjtat nuk qëndrojnë, në ankesën e tij parashtruesi ka shprehur pakënaqësi lidhur me rrjedhën e procedurës dhe kundër vendimeve, të cilat janë marrë në çështjen në fjalë, respektivisht ndaj aktvendimit me të cilin të paditurit i 'u ka dërguar padia e paditësit për përgjigje në padi. Në ankesën e tij nuk ka përmendur ndonjë rrethanë apo shkelje të caktuar të gjyqtarit së rastit ashtu siç kërkohet edhe me dispozitat ligjore në fuqi të ligjit nr. 06/L 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në ankesën e tij nuk ka bërë një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore kundër gjyqtari në fjalë, por ka shprehur pakënaqësi lidhur me veprimet procedurale dhe vendimet e gjyqtarit të çështjes e të cilat nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit nga autoritet kompetent. Gjyqtari në veprimet e tija procedurale është i pavarur dhe ndaj çdo vendimi lejohet ushtrimi i mjeteve juridike sipas dispozitave ligjore.

Andaj siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
AD.nr.12/2021 datë 15. 11.2021



Kundër këtij aktvendimi nuk parashihet e drejta e ankesës.